



---

## Asociacioni i Komunave të Kosovës

### R A P O R T

nga

**Takimi i Kolegjiut për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale**

**Mitrovicë, 27 maj 2011**

---

**Për:** Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

**Nga:** Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjumeve të AKK-së

**Lënda:** Raport nga takimi i Kolegjiut për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale



## **HYRJE**

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale organizoi takimin e parë të Kolegjiumit për këtë vit në restorantin 'Dodona' në Mitrovicë (Bajgorë) me datën 27 maj 2011 (e premte) me fillim nga ora 11:00.

Takimi kishte për qëllim të diskutohej rendi i ditës i përcaktuar më parë nga Kryesia me këto pika:

1. Ri-organizimi i Kolegjiumit
2. Prezantim i projektit të DFID-it për mirëqenie sociale dhe Plani i Punës për mirëqenie sociale
3. Pjesëmarrje në Grupet Punuese qeveritare për Ligjet relevante
4. Rekomandim për decentralizimin e shërbimeve sekondare shëndetësore
5. Punësimi i mjekëve të ri

Në këtë takim morën pjesë Drejtorë të Drejtorive për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale të Komunave të Kosovës, znj. Qamile Ramadani- menaxhere nga DFID si dhe përfaqësues të AKK-së. Takimi u kryesua nga Kryesuesi i Kolegjiumit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale z. Xhafer Dema.

## **PËRMBLEDHJE**

z. Xhafer Dema, Kryesues i Kolegjiumit: falënderoj AKK-në për organizimin e këtij takimi të parë si dhe të gjithë pjesëmarrësit në këtë takim. Kryesuesi prezantoi rendin e ditës, dhe pas miratimit në mënyrë unanime vazhdoi me pikën e parë:

- Ri-organizimi i Kolegjiumit

z. Dema: disa komuna kanë bërë një ndarje të Drejtorive në atë të shëndetësisë dhe atë të mirëqenies sociale. Gjatë takimit të Kryesisë është rënë dakord që për këto shërbime ti ndajmë punët në dy pjesë: shëndetësia do të udhëhiqet nga Kryesuesi z. Xhafer Dema, ndërsa mirëqenia sociale do të udhëhiqet nga zv. Kryesuesi i Kolegjiumit z. Bashkim Hyseni, i cili do të jetë Kryesues për mirëqenie sociale.

Është mirë që kryetarët ta rishikojnë nëse është e mundshme ndarja e Drejtorive për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, mirëpo sipas disa njoftimeve paraprake kjo gjë është shumë e vështirë. Po ashtu të kemi parasysh të identifikojmë personat të cilët do të përfaqësohen në komisionin për sh. sociale i cili kryesohet nga z. Bashkim Hyseni.

- Prezantim i projektit të DFID-it për mirëqenie sociale dhe Plani i Punës për mirëqenie sociale

Në fjalën e saj znj. Ramadani nga DFID sqaroi qëllimin e programit të DFID-it në përforsimin e sistemit financiar dhe administrativ për decentralizimin e shërbimeve sociale. Ky program do të mbështes zhvillimin e kapaciteteve të Kolegjiumeve për të koordinuar dhe lehtësuar dialogun në lidhje me shërbimet sociale për njerëzit në nevojë. Përfitues të këtij projekti do të jenë MPMS, MAPL, MEF, AKK me Kolegjiume. Në nivel lokal përfitues janë Drejtoritë Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Drejtoritë për Buxhet dhe Financa dhe Qendrat për Punë Sociale.

Rezultati pritet të jetë kapaciteti i zhvilluar i Qeverisë së Kosovës për të planifikuar dhe menaxhuar shpenzimet publike për shërbime të kujdesit social, në kuadër të planeve të qarta të shpenzimeve, duke u bazuar në një analizë të nevojave për shërbimet e kujdesit social.

z. Dema: do të jetë një projekt i mirëpritur dhe shumë i nevojshëm duke marrë parasysh gjendjen e vështirë ku gjenden shërbimet sociale.

z. Bashkim Hyseni – zv. kryesues: sqaroi të pranishmit se në bashkëpunim me AKK-në, është diskutuar ndarja e Drejtorive, mirëpo të gjithë e dimë se kjo gjë është shumë e vështirë të arrihet për shkakun e thjeshtë të problemeve në financimin e këtyre zyrave. Mirëpo ne e kemi parë të arsyeshme që Kolegjiumi të shkojë një hap përpara duke ndarë punët për të bashkëpunuar me projektin e ri të DFID-it i cili fokusohet në decentralizimin e sh. sociale në komuna. Jemi në përgatitje të planeve për funksionalizimin e strukturës dhe organizimit të punës së zyrave komunale për sh. sociale. Në një kohë të shkurtër do të bëjmë shpalosjen e agjendës dhe shpërndarjen e të gjitha informatave të nevojshme për këtë projekt tek të gjithë pjesëmarrësit.

z. Munoglu: shtoi se GIZ-i ka shfaqur interes për një projekt të ri në fushën e mirëqenies sociale, me fokus ndihmën e viktimave të trafikimit, ku qendrat sociale do të kenë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe strehimin e këtyre viktimave. Projekti është në fazën fillestare dhe për punën e mëtutjeshme do të njoftoheni me kohë.

z. Dema : nëse keni ndonjë vërejtje adresoni shqetësimet tuaja tek z. Hyseni për çështjet lidhur me sh. sociale.

Në planin e punës parashihet që në kuadër të kolegjiumit të formohet Komisioni i cili do të merret me çështjet e shëndetësisë, prandaj është mirë të përcaktojmë personat të cilët do të angazhohen për punë profesionale. Pas diskutimeve u vendos që Komisioni të përbëhet nga këta 5 anëtarë të Kolegjiumit:

- Xhafer Dema - Kryesues
- Xhemajl Salihu
- Salih Bytyci
- Ismet Jashari
- Shaqir Demiri

z. Gani Demolli –Prishtinë: theksoi se nuk duhet të prezantohet kinse nuk kemi ekspertë për M. Sociale, sepse një gjë e tillë nuk është e vërtetë, problemi thelbësor qëndron në mungesë të kushteve për të mbuluar shpenzimet e nevojshme për këto shërbime. Është e vërtetë se është bërë bartja e kompetencave në nivelin komunal por në anën tjetër nuk kemi mjetet e nevojshme financiare.

Znj. Ramadani: është e vërtetë se procesi i decentralizimit nuk funksionon mirë ashtu si është parashikuar, është deleguar kompetenca te komunat për sh. sociale por të cilat janë gjendur në vështirësi në menaxhimin e mjeteve në këtë sektorë. Ka një zbritje të vazhdueshme të buxhetit prej vitit 2005, dhe një gjë e tillë në të ardhmen mund të lihet në mëshirë të Kryetarëve të Komunave sepse do të parashikohet që financimi të jetë në formën e grantit të përgjithshëm të Komunës. Është mirë që të

ndajmë informatat nga të gjitha palët rreth këtij projekti në përmirësimin e mëtutjeshëm të punës së përbashkët.

z. Hyseni: qëllimi i takimeve të parapara do të jetë shkëmbimi i informatave të nevojshme në mes palëve në përmirësimin e funksionalitetit të punës në fushim e m. sociale. Ende nuk e kemi të qartë nëse sh. sociale do të kenë grant specifik apo do të përfshihen në grantin e përgjithshëm, sepse në lidhje me këtë kemi probleme dhe dyshime të mëdha se si do të operohet në të ardhmen.

z. Dema: do të jetë si pikë e veçantë për takimet e ardhshme të cilat ka planifikuar Kryesia, sepse decentralizimi deri në këtë fazë është i mangët, dhe do të punojmë t'ia bëjmë me dije Ministrisë për problemet me cilat do ballafaqohemi nëse buxheti do të jetë në grantin e përgjithshëm për komunat.

znj. Florije Boshnjaku – Drejtoreshë e DSHMS- Rahovec: theksoj se shërbimet sociale nuk përfshijnë vetëm ndihmën sociale, dhe këtu DFID-i të përkrahë vetëdijësimin e anëtarëve të Kuvendeve Komunale dhe ministrisë, për ndarjen e buxhetit për shërbimet sociale sepse decentralizimi për këto shërbime është kryer por buxheti ende nuk është ndarë.

z. Kastrioti Jashari –drejtor i MS-IE - Mitrovicë: ta kemi të qartë se shëndetësia ka grantin qeveritar por shërbimet sociale nuk e kanë një gjë të tillë. Duhet t'ju sugjeroj se në lidhje me integrimet evropiane komunat duhet të plotësojnë disa kushte, njëri ndër katër objektivat është edhe ai për shërbimet sociale dhe me këtë rast komunat kanë mundësi të aplikojnë për grante nga KE-ja në kuadër të riatdhesimit të personave nga jashtë. Një çështje me rëndësi është edhe ajo e ndarjes së drejtorive, sepse është domosdoshmëri për një punë më efikase dhe profesionale.

➤ Pjesëmarrje në Grupet Punuese qeveritare për Ligjet relevante

z. Munoglu: AKK- ja ka takime të rregullta me zyrën ligjore të Kryeministrit dhe ministrive. Kemi pasur një takim të përbashkët ku jemi dakorduar për pjesëmarrjen tonë në grupet punuese sipas strategjisë legjislativë 2011. Me këtë rast do të ishte mirë identifikimi i personave të cilët do të marrin pjesë në mënyrë aktive në këto grupe dhe ta japin kontributin e tyre profesional në ndryshimin e ligjeve sipas procesit të paraparë.

Pas një diskutimi të shkurtë u vendos që këta persona të marrin pjesë në grupet punuese:

1. Fahrije Bytyqi – K. e Prizrenit: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e asistencës sociale në Kosovë- 15 korrik 2011;
2. Kastriot Jashari - K. e Mitrovicës: Projektligji për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve publike të punësimit në Kosovë 30 qershor -2011;
3. Florije Boshnjaku – K. e Rahovecit: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-17 për shërbime sociale dhe familjare -10 korrik 2011;
4. Gani Demolli – K. e Prishtinës: Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/4 për Shëndetësi -1 qershor 2011;
5. Reshat Gashi - K. e Shtimes: Projektligji për sigurime shëndetësore -1 qershor 2011;

Dhe z. Osman Veliu si zëvendësues i znj. Nazane Breca për licencimin e institucioneve private të kujdesit shëndetësor.

➤ Rekomandim për decentralizimin e shërbimeve sekondare shëndetësore

z. Shaqir Demiri – drejtor i DSH -Mitrovicë: si një çështje shumë e rëndësishme Kryesia ka konsideruar edhe diskutimin e decentralizimit të shërbimeve sekondare shëndetësore. Kemi hasur probleme në përditshmërinë e funksionimit të qendrave mjekësore, për çdo gjë duhet pyetur MSH-në gjë që paraqet pengesa të mëdha në punën e institucioneve sekondare shëndetësore. Prandaj është mirë të diskutojmë dhe të dalim me rekomandimet tona për decentralizim apo rajonalizim rreth menaxhimit të këtyre qendrave për funksionimin sa më të mirë të tyre.

z. Dema : sipas statutit ekziston një këshill prej 5 komunave në nivel rajonal, është mirë të mbështetemi në legjislacionin ekzistues dhe të iniciojmë formimin e këtyre këshillave në nivel rajonal për një funksionim sa më të mirë të shërbimeve primare dhe sekondare shëndetësore. Decentralizimi nuk do të jetë e lehtë duke marrë parasysh qëndrimet e Ministrisë në menaxhimin e plotë të këtyre qendrave, prandaj të parashtrijmë kërkesën për formimin e këtyre këshillave për monitorim më të mirë. Ky këshill është propozuar nga M. e Shëndetësisë në 2007 për të shqyrtuar dhe miratuar planet e punës dhe planet financiare të spitaleve si dhe të bëjë monitorimin e tyre, ndërsa menaxhimi i tyre të bëhet nga stafi menaxhues i spitaleve.

z. Hyseni: ende nuk kemi një plan konkret por është propozim për shtyrjen e këtij procesi përpara në formimin e këtyre këshillave. Në takimet e radhës është mirë të ftojme përfaqësues nga M. e Shëndetësisë për sqarim në këto çështje. Nëse spitalet menaxhohen nga komuna në komunat me pakicë serbe pse kjo gjë nuk mund të aplikohet edhe tek komunat tjera? Është mirë të njoftohemi për këto çështje dhe të bashkërendisim veprimet tona.

z. Dema: Poliklinikat stomatologjike (si institucione të nivelit sekondar) de jure ato që nuk ekzistojnë edhe pse p.sh. në Pejë kanë 55 punëtor, dhe kjo poliklinikë nuk aftëson mjekët e ri. Prandaj është me rëndësi që statusi i tyre të sqarohet mirë. Është mirë që në takimin radhës Kolegjiumi të vij me propozime konkrete.

Znj. Boshnjaku: është me rëndësi të dimë si është rregulluar përfaqësimi i komunave. Nëse është e vërtetë një gjë e tillë atëherë përmes anëtarëve tonë në grupet punuese të kërkohen ndryshimet e nevojshme të ligjit për shëndetësi.

Z. Dema: është mirë që z. Gani Demolli të ngritë këtë çështje në grupin punues legjislativ. Po ashtu kërkojmë që z. Demolli të përgatis një shkresë për M e Shëndetësisë për formimin e këshillave.

z. Xhevat Haziri, Drejtor i DSHMS -Viti: duhet patjetër të kemi një koordinim më të mirë të punës së përbashkët, mirëpo duhet të rishikojmë me kujdes bazën tonë ligjore - kujt duhet ti drejtohem për kërkesat tona, cilat do të jenë përgjegjësitë e këtyre qendrave?

z. Milivoje Jovanović , Drejtor i DASHKRS – Partesh: parashtroj problemin me të cilën has komuna në punësimin e punëtorëve të rinj pas vendimit të komunës për hapjen e qendrës së re familjare z. Dema potencoj se M. e Shëndetësisë duhet të caktoj numrin e punëtorëve në këtë Komunë.

➤ Punësimi i mjekëve të ri

Mjekëve të ri po u mohohet e drejta në aplikimin për specializim sepse nuk kanë përvojë 1 vjeçare. Rreth këtij rasti besoj që jemi dakord që të adresojmë një kërkesë Ministrisë që Drejtorët Komunal tu japin rastin mjekëve të ri për punësim një vjeçar që të fitojnë të drejtën të specializohen në të ardhmen. Pas regjistrimit të popullatës të rishikohen edhe një herë kriteret rreth numrit të punëtorëve shëndetësor.

z. Salihu – Gjilan: Komuna e Gjilanit ka punësuar 19 mjek me kontrata 1 vjeçare përmes Asociacionit të Mjekëve me kontratë njëburimore.

z. Dema: Është mirë që kjo përvojë e Gjilanit dhe procedurat relevante të shpërndahet tek të gjithë përmes e-mailit.

**KONKLUZAT:**

- Është bërë riorganizimi i Kolegjiut dhe është ndarë punë mes shëndetësisë dhe mirëqenies sociale
- Është formuar Komisioni i Kolegjiut për shëndetësi i cili do të takohet sipas nevojës për të shqyrtuar/analizuar tema specifike në kuadër të Kolegjiut
- Janë emëruar përfaqësuesit në grupet punese qeveritare për ligjet relevante
- z. Demolli të përgatis një shkresë për Ministrinë e Shëndetësisë për formimin e këshillave dhe të ngritë këtë çështje në grupin punues për ligjin për shëndetësi.
- z. Salihu të shpërndajë përmes e-mailit tek të gjithë anëtarët e Kolegjiut përvojën e Komunës së Gjilanit dhe procedurat e domosdoshme për punësimin e mjekëve të ri me kontrata një vjeçare.